



VENDIM

Nr. 18 Datë 21.03.2014

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“ENREL HYDRO” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTIRIKE NGA HEC- ET “ZEREC 1” DHE
“ZEREC 2”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.03.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EnRel Hydro” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gërmat “a“, “b“, “c“, “d“, “f“ dhe “g“, është pa plotësuar gërma e (Struktura e ndertimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gërmat “a“, “b“, dhe “d“, është pa plotësuar

germa “c” (Dokumenta qe vertetojne aftesine dhe/ose mbeshtetjen financiare te aplikuesit).

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar pjesërisht: janë plotëuar pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, 4.1.5, është pa plotësuar pika 4.1.3 (Dokumentacioni Teknik dhe Grafik).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikat e sipërcituara, do ti kërkohet subjektit të depozitohet në ERE brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të “EnRel Hydro” sh.p.k, për liçensim në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec - et “Zerec 1” dhe “Zerec 2”
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.